



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur me
24. 02. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini , anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Albulena Gashi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkoviq, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar për Komunitete
4. Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së
5. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
6. Remzi Mehmeti, DMSH
7. Avni Olluri, Drejtor, DGJK
8. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR
9. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
10. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
11. Adem Duriqi, Drejtor i DP
12. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
13. Avdullah Fazliu, Drejtor i DSHMS
14. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
15. Mefail Mustafa, OSBE
16. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
17. Bukurie Zejnullahu-Jashari
18. Përfaqësuesit e mediave
19. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
20. Haki Avdiu, Operator për zërim dhe inqizim të mbledhjes

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë 29 anëtarë nga gjithësejt 31 anëtar hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se para se të procedoj me rendin e ditës ju njoftoj se kemi 5 anëtarë të rinjë të Kuvendit si vijon:

- Nehat Tërpeza në vend të Adrian Rashitit
- Ukë Kryeziu në vend të Enver Bikliqit
- Merita Zeqiri-Hajrizi në vend të Mevlide Shamollit
- Vlora Buja në vend të Shqipe Rexhepit dhe
- Ramiz Qeriqi në vend të Naser Bytyqit.

Në vazhdim ftoi një nga një anëtarët e lartëpërmendur që të japin betimin të cilët duke lexuar deklaratën solemne dhan betimin para Kuvendit.

Pastaj Kryesuesja tha se materialin për këtë mbledhje në formë elektronike e keni marrë me kohë, ndërsa në formë mekanike e keni marrë më vonë. Në vazhdim pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në rendin e ditës së propozuar?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje as plotësime Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të të KK-së
2. Themelimi i Komiteteve.
3. Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin 2013.
4. Propozimi i Vendimit për dhënjën e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës të vitit 2012 dhe 2013 në vitin 2014
5. Informatë nga DKA mbi gjendjen e arsimit në Komunën e Lipjanit.

Në vazhdim Kryesuesja pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka dikush ndonjë pyetje para se të kalojmë në punë sipas rendit të ditës?

Blerim Gashi, kërkoj që të njoftohet Kuvendi se si është gjendja e furnizimit me ujë e gjithashtu qfar resurse të ujit kemi në komunën tonë.

Si pyetje të dytë, pyeti se deri ku kanë ardhur punët për ndarje të banesave kur dihet se komuna që tri vite ka dhënë një objekt me koncesion dhe kemi formuar komisionin për ndarje të banesave.

Te çështja e shëndetësisë e pash në konkurs dhe propozoj që në QKMF të pranohet edhe një mjek kardiolog.

Vlora Limani- Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit tha se përgjigjet për këto pyetje do ti merrni më vonë dhe për të ardhmen pyetjet e tilla ti paraqitni me shkrim.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës së aprovuar.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të të KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Kuvendit?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht,

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Kuvendit pa vërejtje.

Shtesë: Ekstrakti.

II

Themelimi i Komiteteve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni tha se siç e dini edhe ju në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kemi caktuar numrin e komiteteve ku prej tyre 2 janë obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, ndërsa tjerat janë jo obligative dhe në këtë mbledhje kemi caktuar edhe strukturën e komiteteve dhe më pas kemi bërë shpalljen publike për dërgimin e emërave për anëtarë të Komiteteve në afat prej 7 ditësh mirëpo disa subjekte i kanë dërguar emërat e disa nuk i kanë dërgu, andaj besoj që sot, shefat e grupeve parlamentare të LDK-së dhe PDK-së dhe V.V-ja sot do ti propozojnë emërat për anëtarë të komiteteve.

Pastaj Kryesuesja lexoi emërat e anëtarëve të komiteteve të cilët i kanë dërguar subjektet politike dhe komunitetet dhe më pas ftoi shefat e grupeve parlamentare që të propozojnë emërat e anëtarëve të Komiteteve.

Labinot Shahini, shef i grupit parlamentar i LDK-së propozoi si vijon:

- Në Komitetin për Politikë dhe Financa, Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, Agron Hajdini dhe Daut Azemi.

- Në Komitetin për Komunitete, Naim Jahiri
- Në Komitetin për Shëndetësi, Haxhi Bytyqi, Labinot Shahini dhe Sokol Shala.
- Në Komitetin për Arsim, Nehat Tërpeza, Zetëhane Sefedini dhe Skënder Ademi.
- Në Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm, Fadil Sylejmani dhe Ragip Mehmeti.
- Në Komitetin për Bujqësi, Arton Retkoceri, Muhmet Shabani dhe Eqrem Haziri.

Florent Hoxha, shef i grupit parlamentar i PDK-së fiillimisht uroj anëtarët e ri të Kuvendit dhe më pas njoftoi Kuvendin se PDK-ja nuk i ka dërguar emërat e anëtarëve për komitete me që PDK-ja ka dërguar një shkresë në MAPL me të cilën kemi kërkuar që të bëhet interpretimi ligjor lidhur me emërimin e Nënkyetarit të Komunës për komunitete si dhe çelsi lidhur me përbërjen e Komiteteve e derisa të marrim përgjigjen lidhur me këtë shkresë ne nuk do ti dërgojmë emërat.

Edita Gashi, V.V, propozoj anëtarët e Komiteteve nga subjekti i V.V. si vijon:

- Në Komitetin për Politikë dhe Financa, Arben Bahtiri,
- Në Komitetin për arsim, Editë Gashi,
- Në Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm, Rabbit Konjufca dhe
- Në Komitetin për Bujqësi, Ibrahim Kryeziu.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimet për themelimin e Komiteteve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për 10 kundër miratoi propozimet për themelimin e Komiteteve dhe nxori këtë

Vendim Për themelimin e Komiteteve

1. Komitetin për Politikë dhe Financa
2. Komitetin për Komunitete
3. Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenje Sociale dhe kategoritë e dalura nga Lufta e UÇK-së
4. Komitetin për Arsim
5. Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm
6. Komitetin për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Shtesë: Vendimet.

III Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin 2013

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa i cili në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i cili sajton pjesën përbërse të këtij procesverballi.

Në vazhdim tha se në vitin 2013 Komuna ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale në shumë prej 9.202.701,54€ ku prej tyre pagesat janë kryer në shumë prej 3.603.285.89€, ndërsa obligime ndaj kontratave të nënshkruara kanë mbetur 3.603.285.89€. Përveq kësaj Komuna ka borxh të paguara në arsim rreth 1 milion euro çka do të thotë që gjithësejt totali i obligimeve të Komunës

është 6.827.821€. Në bazë të analizave që kemi bërë shifet se kjo gjendje ka ardhur për shkak të nënshkrimit të kontratave të cilat janë bërë pa mbules si shemull po e marr për shumicën e projekteve kanë qenë të parapara 100.000,00€ kurse kemi rast ku për një projekt i tillë kontrata është lidhë në shumë prej 332.000,00€. Në vazhdim tha se ne jemi duke shqyrtuar mundësitë se si ti paguajm këto borxhe me që për vitin 2014 projektet e pa përfunduara nuk janë paraparë.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, falenderoj Drejtorin për praqitjen e këtij raporti me që kjo është e domosdoshme që edhe ne edhe qytetarët të dinë se Komuna ka borxh rreth 7 milion euro dhe ne do të përpiqemi që të punojmë konform ligjeve dhe paraja publike do të shpenzohet konform ligjeve në fuqi.

Ragip Zejnullahu, e pashëtë arsyeshme me reagu në fjalimin e Drejtorit të Buxhetit me që është më shumë politik ky fjalim por ka edhe diqka që nuk mund të anashkalohej. Unë e di se planifikimi i qeverisjes së kaluar ka qenë unikat dhe ne e kemi ditë që për disa projekte nuk kanë mjaftuar mjetet e parapara për përfundim të projekteve. Më tepër u fol për rrugën 4 kursi si dhe për kanalizimin në Baicë, shkollën në Sllovi dhe rrugën në Poturovc ku janë nënshkruar kontratat pa pasur mjete të planifikuara.

Për rrugën 4 kursi kanë qenë të planifikuara 500 mijë euro dhe nga Ministria janë premtuar 2 milion euro.

Për kanalizimin në Baicë e kemi parapa me mjete vetanake dhe në fillim nuk ka pasur mjete për këtë projekt më që dihen vështërsit për realizimin e mjeteve vetanake.

Te shkolla e Sllovisë është e vërtet se nuk ka qenë e planifikuar por ka pasur një donacion nga një shoqatë Zvicërrane dhe për mos me humbur këtë donacion kemi nënshkruar kontratën për rregullimin e kësaj shkolle.

U përfolën 3 projekte për të cilat janë nënshkruar kontratat në kuadër të këtyre është edhe rruga në Poturovc dhe kemi pasur një marrëveshje me Ministrinë e transportit për 300 mijë euro për realizimin e këtyre projekteve ku 7% të këtyre projekteve është dashtë me i mbuluar Komuna dhe për mos me i humb këto mjete janë nënshkruar kontratat.

Shkelzen Hajdini, fjalimi im aspak nuk është politik dhe unë e elaborova me numra gjendjen si është dhe askund nuk kam gjetur marrëveshje për 2 milion për rrugën 4 kursi dhe nëse ju e keni një marrëveshje të tillë ju lutem na sillni.

Ali Stublla, unë rastësisht këtu i pash 3 projekte ku Ministria e arsimit për këtë vit i ka ndarë 600 mijë euro dhe nuk e di pse prokurimi hesht për këtë çështje.

Arben Bahtiri, unë nuk do të lëshohem në shifra por sipas këtij raporti shifet se qeveria e kaluar buxhetin nuk e ka udhëhequr si psuri publike por si pasuri private dhe kjo çasje ka sjellur deri te keq orjentimi i investimeve që më pas përmes të këtij buxheti kanë përfitu individet dhe bizneset të cilat kanë qenë të lidhura ngusht me pushtetin. Në vazhdim tha se që çdo keq përdorim i buxhetit që është evidentu të dërgohet te organet kopetente për hetime të mëtejme se çdo keq përdorim i parasë publike është vepër penale. Kam edhe një pyetje për Drejtorin se si do të tejkalojnë këtë situatë kur tha se burxhe janë rreth 7 milion.

Blerim Gashi, na edhe në mandatin e kaluar kemi kërkuar që mos të planifikohen projekte për të cilat nuk janë mjetet dhe për këtë shkak kemi ardhur deri te ky borxh dhe po shifet se qeveria nuk ka investuar fare në projektet tona. Gjithashtu 136 mijë euro kanë shkuar në suficit a në anën tjetër kemi borxhe.

Nazmi Krasniqi, uroj që ky Kuvend të shkoj mbarë. Në vazhdim tha se diskutuesi i mëparshëm Blerim Gashi ka qenë delegat dhe në mandatin e kaluar dhe ka votuar për këto projekte që u përmenden kurse tani i kondërshton dhe kjo për mua është e pa pranueshme.

Daut Azemi, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e raportit i cili raport është shumë i kuartë dhe aspak nuk është politik siç e than disa këtu por ky raport pasqyron gjendjen reale se si ka qeveris qeveria e mëparshme dhe për keqpërdorimet që janë bërë duhet të mirren organet kopetente.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se gjendjen që e kemi gjetë është sfidë edhe për neve edhe për qytetarët. Populli thotë një shprehje nëse është hëngër pitja tepsia është dhe këtu kemi të bëjmë me numrat ashtu siç është gjendja. Mjetet që janë paraparë për investime kapitale shifet se borxhet janë dyfish më të mëdha në krahasim me mjetet e parapara dhe mendoj se këtu nuk ka politikë, por duhet të angazhohemi të gjithë për tejkalimin e kësaj gjendje.

Pastaj tha se 149 mijë euro i kemi borxh KEK-ut dhe këto mjete nuk janë parapa me buxhetin e këtij viti, gjithashtu ka pasur raste që dikush ka marrë rrugë pa shkuar fare në punë dhe dikush për këto lëshime duhet me marrë përgjegjësinë.

Enver Kozhani, Kryetari tha se në listë të pagave ka njerz që fare nuk punojnë a marrin rroga, kërkoj që Kryetari të na i jep me emër e mbiemër ata njerz.

Feriz Hasani, me të vërtetë po shifet se borxhet janë të mëdha dhe duhet të punojmë bashkarisht për tejkalimin e kësaj gjendje.

Ali Stublla, Kryetari më parë tha se nuk duhet të bëjmë shpenzime kurse Kryetari vetë krijon shpenzime duke formuar komisionet për verifikim të kontratave të cilat komisione punojnë edhe ditëve të vikendit që sigurisht paguhen e aq ma keq këto komisione janë formuar nga njerz familjar.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, thase është e vërtetë se unë kam formuar një komision me ekspert të jashtëm ku mendoj se jam kompetent. Arsye pse e kam formuar këtë komision me ekspert të jashtëm janë se njerzit kanë pasur akses qoftë në dhënjën e tenderave qoftë në cilësi qoftë në mbikqyrje dhe ka pasur konflikt interesi. Për kompetencën e di vet dhe nuk ka nevojë për këshillë. Unë mendoj se transparenca duhet të jetë në nivel dhe nëse mendoni me u mbyllë e keni gabim. Në fillim e thashë se kemi krizë financiare dhe këtë duhet ta pranojmë dhe duhet të angazhohemi të gjithë për ti zvogluar borxhet. Po i kthehem apert Ragipit dhe po i tregoj se këtu nuk është politikë por janë faktet që i kemi qitur në raport. Për emërat që i kërkoj Enveri do të jenë publik, bile këta emëra do të kenë edhe prokurorët se janë kontratat që është i pa kualifikuar dhe merr rrogën e profesorit e unë nuk i kam shkruar ato kontrata.

Florent Hoxha, na si ekzekutiv në vitin e kaluar kemi pasur ekspert të brenshëm në kuadër të ekzekutivit të cilët kanë hartuar projekte. U tha se Komuna ka obligime të mëdha që kjo është e vërtetë por kërkoj që sëbashku të angazhohemi që ti paguajmë këto obligime në bashkëpunim me ministrinë të cilat na kanë premtuar më heret.

Në kuadër të Ministrisë së arsimit janë parapa 600 mijë euro për këtë vit për përfundimin e projekteve për shkollat.

Për rrugën 4 kursi që është lidhur kontratë në shumë prej 2 milion e 800 mijë euro kemi pasur biseda me Ministrinë e infrastrukturës që do të na ndihmon në këtë projekt.

Pastaj tha se kemi pasur ndërprerjen e disa projekteve për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Arben Bahtiri, kërkoj sqarim me që në këtë raport e pash pastrimi i rrugës dhe hedhja e kripes ku është nënshkruar kontrata dhe janë paguar mjetet në shumë prej 14 mijë euro a unë nuk e di që sivejt është hedhë kripë.

Labinot Shahini, u tha se këto janë politike, por unë nuk pash asnjë gjë që është politike në këtë raport me që këtu janë numrat dhe shifet se asnjë kontratë nuk ka përfunduar si duhet.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim raportin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave

Arovio

Raportin vjetor të shpenzimeve për vitin 2013

Shtesë: Raporti.

Në ora 12,⁰⁰ u dha pauzë deri në ora 13,⁰⁰

Pas pauzës në ora 13,¹⁰ pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë Kuvendi vazhdoi mbledhjen dhe u kalua në punë sipas pikës së katërt.

IV

Propozimi i Vendimit për dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës të vitit 2012 dhe 2013 në vitin 2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limni-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit i cili sajón pjesën përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Arben Bahtiri, në bazë të këtij Vendimi shifet se shpenzimet e buxhetit nuk janë bërë si duhet nga qeverisja e kaluar, andaj kërkoj nga qeverisja e tanishme që të ketë kujdes gjatë shpenzimeve të buxhetit dhe shpenzimet të jenë të arsyeshme.

Petrit Kelmendi, të hyrat vetanake të cilat janë grumbulluar gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor për shkak të procedurave nuk kanë mund të realizohen dhe është mirë që këto mjete mund të shfrytëzohen dhe zvogëlojnë borxhet që u përmendën më heret dhe ne e përkrahim këtë Vendim.

Blerim Gashi, edhe ne e përkrahim këtë propozim Vendim me që të hyrat vetanake nuk kanë mundur me u realizuar në fund të vitit mirëpo këto të hyra mund të bartën në vitin vijues.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e votimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi këtë

Vendim

Për dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës të vitit 2012 dhe 2013 në vitin 2014

Shtesë: Vendimi.

V

Informatë nga DKA mbi gjendjen e arsimit në Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja i dha vjalën Rasim Hasanit, Drejtor i DKA-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata e cila sajón pjesën përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni hapi shqyrtimin?

Nazmi Krasniqi, të cekurat në këtë informatë nuk janë të sakta me që Drejtorati për arsim për çdo vit gjatë mandatit tim kemi shpallur konkurset dhe ate konkursin e rregullt dhe konkursin plotësues, çka do thotë që sipas këtyre konkurseve kemi bërë edhe pranimin e punëtorëve dhe kemi pasur vetëm një ankesë që ka shkuar në gjykatë. Është e vërtetë se janë disa borxhe dhe Drejtoria zavendësimet për lehonat që kanë shkuar në pushim nuk kemi mundur me i paguar dhe këtu nuk është faji i jonë por i ministrisë që nuk ka qitur mjete.

Vlora Limani-Hajnuni, kjo informatë është sjellë nga Drejtori i arsimit me kërkesën e këtij Kuvendi dhe gjendja është paraqitë ashtu si është dhe nuk e di pse po e politizoni.

Labinot Shahini, këtë informatë e ka kërkuar grupi parlamentar i LDK-së me që për afërsisht e kemi ditur se gjendja në arsim nuk është e mirë.

Disa punëtorëve arsimor një kohë bukur të gjtë nuk ju kanë paguar pagat a dihet se kur punëtori nuk merr paga mungon vullneti për punë dhe niveli i mësimi bjen.

Rasim Hasani, ish Drejtori i arsimit i din mirë të bëmet e veta e tani mundohet ti mbuloj ato.

Borxhet që janë krijuar nuk kanë mundur të krijohen për shkak të lehonave por këto borxhe janë krijuar për shkak të krijimit të paraleleve dhe rritjes së numrit të punëtorëve arsimor. Në ekonominë e shkollës nuk është punuar fare dhe na do të bëjmë ristrukturimin e saj.

Edita Gashi, gjendja në shumë shkolla të Komunës së Lipjanit është e mjerushme sa i përket higjienës. Sa i përket çështjes së pranimi të punëtorëve nga qeverisja e kaluar pranimi është bërë në baza familjare.

Ali Stublla, Drejtori i arsimit e përmendi shkollën e mesme në Lipjan se nuk ka kanalizim por kanalizimi është dhe është ndërtuar para 3 viteve kurse kanalizimi i Qytetit është ndërtuar para një viti dhe niveli i këtij kanalizimi është më i lartë kështu që kanalizimi i shkollës nuk mund të kyqet dhe është kërkuar nga ministria që të bëhet një zgjidhje e këtij kanalizimi por nga Drejtoria nuk është marrë asnjë hap për zgjidhjen e këtij problemi. Gjithashtu u përmend edhe shkolla Ismaj Luma ku edhe jamë Kryetarë i kësaj shkolle dhe kurr nuk e kam parë Drejtorin që ka ardhur aty dhe me pa se në qfarë gjendje është shkolla kur dihet se në këtë shkollë mësojnë edhe nxënësit e shkollës fillore “Vllëzërit Frashëri” e gjithashtu edhe pranimin e punëtorëve e bën pranimin nga radhët e LDK-së

Daut Azemi, unë e dëgjova informatën dhe sipas kësaj informate shifet se ka qenë keqmenaxhim në arsim. Shembull po e përmendi rastin e shkollës së re në Gadime ku është bërë pranimi teknik i kësaj shkolle dhe nxemja nuk funksionon fare dhe nxënësit janë detyruar që të kthehen në shkollën amë në Babush.

Nazmi Krasniqi, informata që u paraqit është e vërtetë që është politike sikurse që është e vërtetë se ka pasur edhe disa lëshime por janë edhe rezultatet të cilat fare nuk përmenden në këtë informatë dhe jamë shumë i lumtur që kam muaj me i rua investimet prej 7 milionëve të Norgeweltit ku në këtë shkollë është dashtë të pranohen 28 punëtorë por për shkak të mungesës financiare e kemi zvogëluar numrin e punëtorëve.

Rasim Hasani, Nazmiu e tha se është përpjekë për mi ruajt investimet e Norgesweltit por kjo nuk qëndron dhe nëse e kanë ruajt atëherë dihet se i kanë ruajt për punësimin e njerzve të vetë sëbashku me Kryetarin. Sa i përket shkollës Ismaj Luma gjendja është shumë e keqe me që kanalizimi nuk është i lidhur me kanalizimin e Qytetit për shkak që kjo shkollë është ndërtuar pa kritere.

Gjimnazi ka filluar me u ndërtuar para 4 viteve dhe ka problem për kyqje edhe në kanalizim edhe të rrjetit elektrik për shkak se kjo shkollë është ndërtuar pa kritere dhe nuk e ka lejen e ndërtimit.

Xhevat Olluri, ne e pamë edhe te raporti i shpenzimeve vjetore edhe te pika që po e shqyrtojmë se ka pasur keqmenaxhim. Sot kemi 136 punëtorë të arsimit që nuk marrin rrugë dhe kjo tregon se gjendja nuk është e mirë, andaj kërkoj nga Drejtori për sanimin e kësaj gjendje dhe zgjidhjen e këtyre problemeve.

Blerim Gashi, në përgjithësi na nuk mund të jemi të knaqur me gjendjen në arsim e posaqërisht kur shofim këto shifra në informatë, dhe po shifet se është përzi direkt politika në arsim. Na edhe më heret kemi shqyrtuar çështjen e arsimit e posaqërisht mos pagesën e pagave të punëtorëve të arsimit ku janë mbajtë një kohë të gjatë dhe nuk ka guxuar as me ankuar në gjykatë. Gjithashtu përmendi edhe objektin e gjimnazit i cili ka filluar të ndërtohet qe 4 vite dhe ende nuk ka përfunduar dhe dashtë zoti që këtë vitë të përfundon dhe të fillon mësimi në atë objekt.

Hajrije Salihu, është një faktë i pamohueshëm se arsimit është në gjendje të mjerueshme dhe duhet të ndërmarrim të gjitha masat për ngritjen në këmbë të arsimit dhe është e domosdoshme që të bëhen reforma në arsim. Gjithashtu Drejtoria duhet të mirret më shumë me sigurin në shkolla dhe policia të jenë prezente më shumë në shkolla e jo vetë kur i thirr Drejtori. Sa i përket zgjedhjes së Drejtorave mendoj se duhet të zgjedhen ata që janë meritore qofshin edhe të partisë.

Florent Hoxha, në informatë është përmend Departamenti a duhet të thuhet Drejtorati me që me Statut janë Drejtorate. Gjatë mandatit të kaluar Drejtori i arsimit dy herë në vit ka paraqitur raport në Kuvend mbi gjendjen në arsim ku janë paraqitur edhe të arriturat e gjithashtu edhe problemet me të cilat është ballafaqu arsimit dhe në bazë të konstatimeve janë nxjerr rekomandimet për tejkalimin e problemeve dhe vështërsive. U tha prej parafolësve që arsimi mos të politizohet por tani edhe ekzekutivi edhe të tjerët janë politizuar. U përmend se Drejtorati nuk e ka bërë licencimin dhe dihet se Drejtori i arsimit nuk e bën licencimin. U tha nga Drejtori se kanë qenë në listën e pagave 10 punëtorë që nuk kanë punuar dhe kërkoj që të paraqiten me emër dhe mbiemër. Në fund tha se gjatë këtij mandati 6 vjeçarë ka pasur rezultate që nuk mund të mohohen si në ndërtim të shkollave ku është ndërtuar shkolla Ismajl Luma me donacion e gjithashtu shkolla “Vëllëzërit Frashëri” dhe shkolla në Llugaxhi. Pastaj kërkoj që në kuadër të kësaj informate të propozohet një rekomandim se si të dalim apo ti zgjidhim këto probleme.

Rasim Hasani, unë nuk i përmenda me emëra se kush janë ata që kanë marrë paga pa punuar fare por kush dëshiron ta di nga Kuvendi mund të vij në Drejtoratin e arsimit se këto që i kemi paraqitur në informatë janë fakte.

Arben Bahtiri, unë e di se ka probleme në arsim dhe këto probleme nuk janë krijuar vetëm që 6 vite por që 13 vite. Në vazhdim pyeti se kur do fillaj punën shkolla “Vëllëzërit Frashëri”.

Në Kraishtë gjendje në shkollë është shumë e rëndë. Si do të kryhen obligimet ndaj punëtorëve që nuk kanë marrë paga.

Rasim Hasani, inspektorët sanitarë në nivel komunal kanë bërë vizita në të gjitha shkollat dhe konstatimi i tyre është se gjendja e shkollave në Rubovc, në Adem Gllavicë në aneksin e shkollës në Banullë, Resinovc, Kleçë, Bregu i Zi dhe Vrellë të Gadimës gjendja është e rëndë.

Në shkollën fillore “Vëllëzërit Frashëri” kemi shpresë që shumë shpejt do të filloj puna. U tha nga Ministria e arsimit janë ndarë 600 mijë euro dhe këto mjete Ministria do ti paguaj në bazë të punëve që kanë me u kryer. Sa u përket punëtorëve të arsimit që janë jashtë listës së pagave unë do të përpiqem që të futen në listën e pagave, kurse për burxhet nuk e di si do ta zgjidhim problemin.

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***